



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR

RELACION
PËR PROJEKT VENDIMIN

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FATKEQËSINË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESËN E Z. BEXHET MELKE HASANLLARI FSHATI ÇOROTAT , NJËSIA ADMINISTRATIVE ZHEPË, BASHKIA SKRAPAR .

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Skrapar,

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 , “ Për mbrojtjen civile” , VKM nr. 329 datë 16.05.2012, “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, me propozim edhe të Kryetarit të Bashkisë, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak :

- Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare nga fondi i Emergjencave Civile , në vlerën 360.000 (treqind e gjashtëdhjet mijë) lekë sipas preventivit të vlerësimit të banesës së djegur nga zjarri i datës 09.08.2024, shpërblimi financiar është i pjesshëm .

Sipas raportit të ndërhyrjes nga sektori i M.Z.SH Skrapar, objekti shtëpi banimi 1 (një) katëshe, është përfshirë nga flakët në mënyrë të papritur, rreth orës 17:00 të datës 09.08.2024 .Sipas proces-verbalit të mbajtur më datën 16.10.2024 në banesën e z Bexhet Melke Hasanllari, fshanti Çorotat, Njësia Administrative Zhepë, Grupi i punës ka konstatuar dëme të mëdha dhe një djegje totale të banesës, të cilat janë të detajuara në proces-verbalin e sipërpërmendur .

Familja e Z. Bexhet Hasanllari jeton në vështirësi ekonomike, pasi kryefamiljari është i pamundur fizikisht të punojë, jetesa bëhet akoma më e vështirë. Familjarët nuk kanë mundur të nxjerrin asnjë orëndi nga banesa, pasi është djegur për një kohë të shkurtër, me fatin e vetëm të mirë, nuk pati dëme në njerëz..

**KRYETARI I BASHKISË
ADRIATIK MEMA**

